



063/1

981

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR

Nr 477/1 Prot.Gjirokastrë, më 19/05/2017.

Lënda: Kthim përgjigje.

Drejtuar: Z. Dorian Matlija
Drejtor Ekzekutiv
Qendra "Res Publica"

Tiranë

I nderuar z. Matlija !

Në kuadër të Ligjit Nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" si dhe Urdhrit Nr. 43 prot., datë 19.01.2015 të Rektorit, të dhënat për buxhetin, planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit që i takon Universitetit "Eqrem Çabej", hyn në kategorinë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe gjendet në faqen e web-it të institucionit tonë, në linkun <http://www.uogj.edu.al/index.php?page=buxheti-i-universitetit>.

Me konsideratë të lartë,



UNIVERSITETI “EQREM CABEJ”

ZYRA E KANCELARIT

Gjirokastër më 14.01.2017

DETAJIMI I BUXHETIT PËR VITIN 2017

PËRGATITUR NGA :KANCELARI I UNIVERSITETIT

DREJTUAR : SENATIT AKADEMIK të Universitetit “Eqrem Cabej” Gjirokastër

BORDIT të Universitetit “Eqrem Cabej” Gjirokastër

KËTU

Në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të Ligjit Nr.80/2015 datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 49,pika c) ,të Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 ”Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar si dhe të shkresës Nr.12966/1 datë 28.12.2016 të MAS-it (bashkëngjitur),si dhe të ardhurave të arkëtuara për llogari të institucionit tonë bëhet detajimi i buxhetit për vitin 2017.

Për detajimin e këtij Buxheti, zyra e Kancelarit, është nisur nga disa faktorë të rëndësishëm sic janë :

- gjendja reale e infrastrukturës së institucionit,**
- plotësimin e disa kriterëve që janë objekt vlerësimi për akreditimin e Universitetit**
- perfeksionimin e bazës praktike e laboratorike në funksion të procesit të mësimdhënies.**
- nxitjen dhe stimulimin e studentëve në veprimtari sociale dhe shkencore.**
- ndryshimet e mundshme (në pritje) në strukturën e Universitetit**

Në kushtet e zbatimit të Ligjit të ri të Arsimit të Lartë, të perfeksionimit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në institucion , nga zyra e Kancelarit janë vlerësuar dhe inkurajuar të gjitha kërkesat e

Zyra e Kancelarit

Tel. & Fax. 00355 84 26 75 71

e-mail:sotiragoci@yahoo.com

Departamenteve të cilat kanë një ndikim të konsiderueshëm dhe të drejtpërdrejt në prefeksionimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

Gjithsesi në mungesë të hartimit të një strategjie të zhvillimit të institucionit të hartuar nga Senati Akademik i Universitetit, e cila është në hartim e sipër, ky buxhet nuk mund të jetë në një shkallë të lartë gjithpërfshirjeje, por gjithsesi do të jetë një start për obligimet dhe sfidat e reja të institucionit për periudhën në vazhdim.

Të konkretizuara këto detajime në vlera dhe argumenta jepen si më poshtë

-I TRANSFERTË E PAKUSHTËZUAR :

FOND PAGASH ,SIGURIME SHOQËRORE e SHËNDETËSORE DHE SHPENZIME OPERATIVE

Sipas shkresës Nr.12966/1 datë 28.12.2016 të MAS-it, është çelur transfertë e pakushtëzuar për institucionin tonë 260.496.000 lekë ,prej të cilave 252.496.000 lekë është fond për institucionin dhe 8.000.000 lekë është fondi në dispozicion për bursat e studentëve për vitin 2017.

Kjo transfertë e pakushtëzuar do të planifikohet për të përballuar pagat e punonjësve, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore nga punëdhënësi për vitin 2017, si dhe një pjesë të shpenzimeve operative për vitin 2017.

Nisur nga fakti që akoma nuk kanë dalë aktet nënligjore për zbatimin e Ligjit të ri të Arsimit të Lartë, nga ana jonë për këtë planifikim do të merren parasysh të gjitha kërkesat e këtij Ligji, duke parë kushtet reale të funksionimit të institucionit tonë, si në lidhje me strukturat e përcaktuara në të, po ashtu edhe në lidhje me nivelin e të ardhurave që realizon institucioni, pasi një pjesë e pozicioneve të përcaktuara në ligj do të jenë kategorikisht të kushtëzuara nga këto të fundit.

1-Transferta e pakushtëzuar për vitin 2017 është e mjaftueshme për të përballuar të gjithë fondin e domosdoshëm për paga e sigurime shoqërore, referuar edhe tabelës analitike të fondit të pagave në projekt buxhetin e viti 2017.Nga përlllogaritja e fondit për pagat sipas strukturës organike aktuale të Universitetit dhe kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore sipas legjislacionit në fuqi, duke marrë në konsideratë strukturën e kualifikimit të stafit akademik, dhe në mbështetje të të VKM.-së Nr.550 datë 11.08.2011”, të VKM-së Nr. 507 datë 01.08.2012 “Për disa ndryshime në VKM. Nr.748 datë 11.06.2009, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit Akademik të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë, i ndryshuar” duke patur parasysh faktin se sa është numri i pedagogëve që janë në procesin e studimeve pasuniversitare për kalimin e shkallëve të kualifikimit, ose të titujve që mbajnë aktualisht, mbi ndryshimin e pagave të personelit, mbi ndryshimet e miratuara deri tani në strukturën e Departamentit Ekonomik në Fakultet Ekonomik, si dhe për ndryshimet e reja në personel,sipas Ligjit të ri të Arsimit të Lartë,për fondin e pagave, përlllogaritim si më poshtë:

-PAGA : Stafi akademik dhe personeli mbështetës planifikohet fond page në vlerën – 200.000.000 lekë.

Nisur nga struktura aktuale e institucionit për 194 punonjës , mbi pritshmërinë e miratimit me VKM të rritjes së pagave (nga ana jonë është përlogaritur një rritje page nga 5-8 % , ku 5 % është përlogaritur për stafin akademik dhe 8% është përlogaritur për punonjësit me pagë minimale që kryesisht janë të punësuar në administratë) dhe ndryshimet e mundshme të strukturës pas miratimit të strukturës së re nga Bordi i Universitetit (është planifikuar paga për Dekan dhe Zv/Dekan të Fakultetit Ekonomik , si dhe tre administratorë fakultetesh për periudhën Prill – Maj 2017), si dhe nga problemet e hasura gjatë vitit 2016 për planifikimin e mundshëm por te pazbatuar deri në fund të vitit 2016 në lidhje me fondin e pagave mendojmë se ky fond do të jetë i mjaftueshëm për të përballuar të gjitha ndryshimet në strukturë sipas akteve nënligjore që do të dalin në vazhdimësi.

Në këtë fond është përlogaritur edhe fond i vevcantë në vlerën 5% mbi fondin e pagave për shpërblimin e punonjësve sipas legjislacionit përkatës. Megjithatë pavarësisht nga ky planifikim, gjatë vitit buxheti do të ndiqet me rigorozitet duke menaxhuar situatat për një përdorim sa më efektiv të pagesës së punonjësve të institucionit.

Në krahasim me vitin e kaluar, ku realizimi i fondit të pagave ishte në masën 179.167.492 lekë duhet të theksojmë se në këtë fond është mbuluar edhe një pjesë e pagesave të orëve part time, të pagesave të orëve 30-70 % mbi ngarkesën mësimore të pedagogëve (fondi real për pagesat e punonjësve arriti vlerën 170.022.203 lekë), pasi kishim fonde të lira nga transfertat e pakushtëzuar .

Gjithsesi , me krijimin e strukturave të reja , pas miratimit nga Bordi i Universitetit , do të bëhet një rishikim i fondit të përcaktuar më sipër, sipas nevojave reale për strukturën konkrete të institucionit, pasi shumë pozicione të reja (administratorë të njësive kryesore, administratorë të njësive bazë) do të jenë kompetencë e Bordit të Administrimit për tu miratuar. Nga ana jonë është planifikuar fond page për një strukturë sa më eficiente dhe radikale , kushtëzuar kjo nga niveli i të ardhurave që realizojmë dhe nga niveli i shpenzimeve që duhet për funksionimin normal të institucionit.

- SIGURIME SHOQËRORE-

Sipas ligjit ekzistues për “Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, vlera vjetore e këtyre kontributeve , (16.7% të fondit të pagës) është 30.000.000 lekë .

Fond page dhe sigurime shoqërore nga Transferta e pakushtëzuar: 230.000.000 lekë

Konkretisht vlera e transfertës së pakushtëzuar do të kalojë: 200.000.000 lekë për pagën e punonjësve (art. 600) , 30.000.000 lekë do të kalojë për kontributin e sigurimeve shoqërore (art.601). ndërsa pjesa tjetër e akorduar si transfertë e pakushtëzuar në vlerën **22.496.000 lekë** , planifikohet të përdoret për shpenzime operative .Detajimi i fondit për shpenzimet operative do të jepet në vazhdim , pasi ky fond së bashku me fondin e të ardhurave për shpenzime operative do të përbëjë dhe pasqyrojë në total vlerën reale të shpenzimeve operative për funksionimin e institucionit në tërësi.

II- SASIA E TË ARDHURAVE NË DISPOZICION PËR T`U PËRDORUR PËR 2017.

Sipas rakordimeve të bëra me Degën e Thesarit sasia e të ardhurave të trashëguara për vitin 2017 është **65.615.433 lekë** .

Zyra e Kancelarit

Tel. & Fax. 00355 84 26 75 71

e-mail:sotiragoci@yahoo.com

Për këtë vit ,ashtu si dhe jemi shprehur në materialin e Raportit vjetor për vitin 2016, parashikohen të realizohen të ardhura në një vlerë shumë më të ulët se vitet e kaluara, pasi ulja e numrit të studentëve do të jetë e konsiderueshme (kemi rreth 388 studentë më pak nga viti i kaluar, dhe kryesisht në master ku janë regjistruar 2/3 e viti të kaluar)pasi një kësht i tarifës së shkollimit për vitin akademik 2016-2017 është arkëtuar që në vitin 2016. Vlera e të ardhurave që mund të realizohen nga tarifat e shkollimit është rreth **43.897.247 lekë**.

Të ardhurat e tjera parashikohen të jenë afërsisht në të njëjtat limite me ato të viteve të kaluara, ndërsa nga qeratat do jenë më të ulëta , nëse fillon rikonstruksioni i objektit të shtëpisë së ushtarakëve.

Të ardhurat dytësore për vitin 2017 sipas burimit të krijimit të tyre parashikohet të jetë si më poshtë:

Nr	Lloji i të ardhurave	Realizuar Viti 2016	Parashikimi 2017
1	Qera	240.852	150.000
2	Tarifa Shkollimi	62.787.654	43.897.247
3	Fotokopje e vërtetime e te tjera	512.785	500.000
4	Sponsorizime	468.471	-
5	Tarife regjistrimi e te tjera (kredite te pashlyera)	206.523	250.000
6	Të tjera	413.074	400.000
	SHUMA	64.629.359	45.197.247
	Trashëguar nga të ardhurat		65.615.433
	TOTALI		110.812.680

Për vitin 2017 parashikohen të kemi të ardhura në dispozicion të institucionit në një vlerë prej **110.812.680 lekë** .

Nga të ardhurat e parashikuara në dispozicion , për vitin 2017 , do çelen si limit përdorimi : **20.000.000 lekë** për zërin e pagave , **20.704.000 lekë** për shpenzime operative ,**15.280.000 leke** do të planifikohet për investimet për vitin 2017.

Gjithsej në total për limit përdorimi për vitin 2017 planifikojmë **55.984.000 lekë** , të detyruar për të lënë një bazë të trashëgueshme për vitet në vazhdim, për të patur mundësinë për të investuar në projekte të cilat kërkojnë shumë fonde : p.sh. dixhitalizimin e bibliotekës, ose kontribut “për rikonstruksionin e Ish-Shtëpisë së Ushtarakëve” nga të ardhurat.

Ky projekt buxhet (shpërndarja e të ardhurave dhe i transfertës së pakushtëzuar) nuk mund të pasqyrojë në tërësi ndërmarrjen e politikave afat shkurtër dhe afat mesëm të zhvillimit të institucionit, por gjithsesi, mbështetur në problemet reale në të cilat ndodhet institucioni ynë dhe të politikave strategjike kombëtare për zhvillimin e institucioneve të arsimit të lartë **politikat që duhet të ndërmerren nga ana jonë duhet të konsistojnë në:**

1-Rritjen e qëndrueshme afatmesëm të të ardhurave të institucionit .

2-Vazhdimin e ristrukturimit të arsimit dhe aftësimin profesional, me qëllim përmirësimin e rolit të trainimit për nevojat reale të tregut të punës.

3-Integrimin e veprimtarisë kërkimore –shkencore me atë të mësimdhënies në nivele reale dhe jo vetëm teorike, për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe aftësimin profesional të studentit , si dhe për të patur një impakt pozitiv në zhvillimin e rajonit .

4-Përmbushjen e të gjitha standarteve mbi të cilat do të bëhet akreditimi i institucionit tonë.

Me fondin e planifikuar për limit përdorimi për vitin 2017, nisur edhe nga politikat e mësipërme do të përballohen shpenzimet dhe investimet nga më të domosdoshme dhe thelbësore për institucionin, .
Më poshtë po ju japim detajimin e fondit nga të ardhurat sipas zërave:

1- PAGA e SHITESA TË TJERA MBI PAGË , NGA TË ARDHURAT E INSTITUCIONIT.

Nisur nga realizimi i vitit 2016, orët e sistemit part-time,(të cilat janë ulur shumë në krahasim me vitet e kaluara) orët suplementare deri në 30% dhe mbi 30 % , dhe pagesa për pedagogë të jashtëm , planifikohet një fond për përballimin e të gjitha këtyre pagesave në vlerën **20.000.000 lekë**. Kjo vlerë do të përballojë të gjitha pagesat e mësipërme, duke e përjashtuar totalisht pagesën e orëve jashtë kohës normale të paguara vitet e kaluara.

Planifikimi i të ardhurave për përdorim në këtë nivel për vitin 2017, për paga personeli krijon mundësinë që ,nga arkëtimi i të ardhurave detyësore të institucionit të ketë hapësira për planifikimin e shpenzimeve të tjera si : blerje laboratorësh, për punë kërkimore e shkencore, apo investime të tjera në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe krijimin e kushteve optimale të ambienteve të punës.

2-DETAJIMI I BUXHETIT PËR SHPENZIMET OPERATIVE 2017,në vlerën 20.704.000 lekë nga të ardhurat dhe 22.496.000 lekë nga Transferta e pakushtëzuar.Në total planifikimi i shpenzimeve operative është 43.200.000 lekë , të cilat të detajuara dhe krahasimisht me realizimin në vitin 2016 do të jepen në tabelën më poshtë.

	Objekti I Prokurimit	Realizuar 2016	Planifikimi 2017
1	Roje civile(kontrate shtese)	475,193	907,000
2	Roje civile	4,988,648	4,593,000
3	Karburant	1,000,000	4,000,000
4	Kanceleri ,boje,fotokopje,printeri etj.	500,000	200,000
5	Kanceleri, shtypshkrime, bojra	2,356,980	2,500,000
6	Materiale pastrimi	330,828	300,000
7	Sherbime kompjuterike	158,160	200,000
8	Mirembajtje fotokopjuesi	120,720	200,000

Zyra e Kancelarit

Tel. & Fax. 00355 84 26 75 71

e-mail:sotiragoci@yahoo.com

9	Materiale elektrike hidraul. Ndert.	649,496	400,000
10	Te tjera materiale zyre,	244,560	500,000
11	Energji	2,070,966	2,300,000
12	Uje	331,771	400,000
13	Telefon	545,046	1,000,000
14	Sherbim postar	88,606	100,000
15	Sherbime te ndryshme, (detyrime tarifore,)	912,785	500,000
16	Mirembajtje mjet transporti (dy mjete)	753,014	1,000,000
17	Materiale dhe sherbime specifike	770,840	700,000
18	Kuota e sigurimit te mjeteve	149,395	300,000
19	Sherbime Interneti,	106,333	240,000
20	Miremb te aparateve kondicioner +kaldaje gjenerator	90,240	300,000
21	Kosto reklam.dhe publik. +buletin	269,962	600,000
22	Kosto legale(etj.miremb kontrate)	108,000	300,000
23	Kosto te seanc bordeve ,mbledh senati	4,134,548	2,500,000
24	Dieta, brenda ,jashte, ekspedita	4,545,302	4,700,000
25	sherbime te printimit dhe publikimit (QSA)	200,000	700,000
26	miremb. godinave ,lyerje e tre godinave jashte	336,960	6,000,000
27	Shpenzime prithe e percjellje	238,100	500,000
28	Shp. Konf. kombetare apo veprimtari lokale		500,000
30	Aktivitete shkencore departam.konferenca kombetare		510,000
31	Konf.Ndërkomb.shkencore	64,800	2,100,000
32	Projekt shkencor Ekonomiku	30,000	300,000
33	Mirëmb. riparime Laboratori I gjuhëve të huaja		450,000
34	Mirëmbajtje sistemi I infor.dhe sistemi alarmit	285,932	300,000
35	Shp. per Qeverine studentore + Departamente	180,000	500,000
36	Transferta të jashtme 605	248,636	1,000,000
37	Akreditime (te institucionit , dy programe te reja)	-	1,600,000
	Totali I shpenzimeve operative		43.200.000

-Në zërin roje civile (zëri 1 dhe 2) është përlogaritur fondi për kryerjen e këtij shërbimi për 12 muajt e vitit, përcaktuar kjo sipas pagës minimale në shkallë vendi , sigurimet shoqërore dhe pagesat e tjera ligjore që përfshin ky shërbim, si dhe Ligjit 75/2014 "Për shërbimin me roje civile" , dhe ky fond përlogaritet në vlerën **5.500.000 lek** , për të dy vend rojet (godinat e Universitetit dhe Ish-Shtëpia e Ushtarakëve) . Është e detyrueshme nga ana jonë planifikimi në këtë masë, pasi jo vetëm duhet të

Zyra e Kancelarit

Tel. & Fax. 00355 84 26 75 71

e-mail:sotiragoci@yahoo.com

mbulohet minimumi i domosdoshëm ligjor për kryerjen e këtij shërbimi, por realisht duhet të planifikojmë edhe mbi këtë minimum për shpenzimet që duhet të kryhen nga kompanitë e sigurimit me roje civile sipas kriterëve dhe kushteve që përcaktojmë ne si autoritet kontraktor. Duke qënë se ky fond kap një vlerë të konsiderueshme në buxhetin e Universitetit, mundësia e ristrukturimit të këtij shërbimi, (duke zëvendësuar rojet civile me personel të brendshëm të Universitetit) është e pamundur, pasi edhe me rritjen e pagave në muajin Mars 2017, trajtimi i pagesës për rojet është në një nivel pothuajse të njëjtë me rojet civile. Kështu që planifikimi i fondit për këtë shërbim do të ngelet afërsisht në nivelin e planifikuar në projekt buxhetin e viti 2017 dhe në nivelin e buxhetit të vitit 2016.

- Në zërin karburant (zëri 3) është planifikuar një fond prej **4.000.000 lekë**, krahasimisht më i lartë se ai i vitit 2016, pasi për vitin 2017 planifikojmë rreth 12.000 litra karburant për sistemin e ngrohjes (nga 7.000 litra harxhuar në 2016): kaldajat të funksionojnë vetëm në 80 ditë mësimore (jo të shtuna të diela, pasi sistemi me kohë të pjeshme do të ketë një numër të ulët studentësh për këtë vit akademik) me orare të përcaktuara cdo vit: 2 orë godina ekzistuese (pasi ka ngrohje alternative) dhe 2 ore paradite dhe 2 orë mbasdite Godina e Ekonomikut, pasi zhvillohet mësim në orët e mbasdites. Për lëvizjen e mjeteve të transportit të Universitetit përllogaritet rreth 13.000 litra karburant për të dyja mjetet së bashku (furgoni planifikohet për 500 litra në muaj dhe makina e titullarit rreth 600 litra në muaj). Në krahasim me vitet e kaluara është planifikuar një vlerë më e lartë karburanti, por sasia e planifikuar për mjetet e transportit është planifikuar në nivelin e viteve të kaluara dhe është planifikuar një sasi karburant më tepër për kaldajat në funksion të ngrohjes së godinave, me qëllim krijimin e kushteve optimale jo vetëm në ambientet e zyrave ku kanë edhe ngrohje alternative, por edhe për sallat e leksioneve dhe seminareve.

Kancelari : zëri 4 dhe 5) Planifikohet në vlerën **3.000.000 lekë** për të përballur furnizimin e institucionit me bazë materiale kancelarike, tonera dhe shtypshkrime, etj. Një peshë të konsiderueshme zënë tonerat e printerave dhe fotokopjuesve, pasi për cdo departament kemi nga 2- 4 printera (ku departamenti mund të ketë edhe nga 10-15 persona) dhe nga një fotokopjues. Gjithashtu edhe zyrat e administratës janë të paisura me printera e fotokopje për të cilat duhet të planifikojmë të paktën nga dy-tre bojra në vit në varësi edhe të volumit të punës që ka cdo zyrë.

Në zërat e tjerë : (nga 6-9 të tabelës së shpenzimeve) materiale pastrimi, materiale hidraulike dhe elektrike, shërbime kompjuterike, mirëmbajtje fotokopjuesish, të tjera materiale zyre. krahasimisht me vitin 2016, është planifikuar në vlerë të njëjtë ose pak më të lartë, për arsye të fondit limit për prokurim si dhe të reduktimit në maksimum të shpenzimeve të këtyre zërave dhe duke përdorur me efektivitet sasi të tyre si ato të reja dhe ato që janë gjendje në magazinë. Fakti që këto shpenzime do të mbulohen nga të ardhurat dytësore, është planifikuar në një vlerë që mbulon nevojat e domosdoshme të institucionit për gjithë vitin kalendarik 2017. Edhe pse janë blerë paisje të reja fotokopje dhe kompjutera nga viti në vit, numri i paisjeve që janë blerë para tre viteve e më parë, përbëjnë pjesën dërrmuese në infrastrukturën elektronike të Universitetit. Këto paisje kanë edhe një kosto të konsiderueshme për riparim dhe mirëmbajtje pasi nga viti në vit amortizohen ose kanë dëmtime mekanike të pjesëve të tyre. Këto paisje nuk mund të dalin të gjitha jashtë përdorimit, pasi nuk

mund të planifikojmë fonde për blerje paisjesh të reja në nivele të larta si dhe për faktin që afati kohor i amortizimit nuk ka kaluar për to.

Në zërat energji, ujë,dhe telefon (zërat 11,12,13) janë shpenzime me karakter tarifor dhe është planifikuar në vlera të tilla edhe nga ndryshimet që kanë pësuar këto tarifa gjatë viteve të kaluara. Në zërin e energjisë elektrike është planifikuar një vlerë më e lartë , pasi deri më sot shpenzime për energji elektrike në ish-shtëpinë e ushtarakëve nuk kemi patur pasi nuk është përdorur nga ana jonë.Nëse do të akordohet fond për rikonstruksionin e objektit do të jetë i domosdoshëm shfrytëzimi i rrjetit të energjisë elektrike për kryerjen e punimeve në këtë objekt.

Për zërin telefon planifikohet pagesa për telefoninë fikse por edhe atë celulare sipas **VKM-së Nr.864 datë 23.07.2010”Për paisjen me numër telefoni celular të personave juridikë publik”**, ku lejohen të trajtohen me pagesën mujore punonjësit e Universitetit sipas pikës 8 dhe 9 të Vendimit të mësipërm dhe kjo vlerë përlogaritet në total **792.000** lekë, vlerë e cila nuk e tejkalon 2% të vlerës së përgjithshme të institucionit të planifikuar për shpenzimet operative, sic kërkohet në këtë vendim. Nga praktika e viteve të kaluara ka rezultuar se ky fond nuk konsumohet totalisht pasi nga punonjësit përfitues të këtij shërbimi nuk konsumohet e gjithë vlera mujore e përcaktuar për secilin si dhe telefonia statike është ulur në një masë të ndjeshme.

Shërbimi postar, (zëri 14)planifikohet në vlerën 100.000 lekë për të përballuar pagesat për shërbimin postar të thjeshtë kryesisht , por edhe shërbimin me postë të shpejtë për ato raste kur gjykohet nga titullari se duhet të përdoret ky shërbim.

Në zërin shërbime të ndryshme (zëri 15);planifikohet kryerja e shpenzimeve për shërbime të ndryshme që janë të domosdoshme për funksionimin e institucionit si: shërbime gjyqësore, akte teknike të funksionimit të institucionit (te mbrojtjes nga zjarri, të raporteve higjeno –sanitare), hostim të faqes së UOGJ, dhe shërbime të tjera të cilat mund të jenë specifikisht per një vit buxhetor.Ky fond pothuajse është përgjysmuar në krahasim me realizimin e viti 2016.

Mirëmbajtje mjete transporti: (zëri 16) planifikohet në një vlerë më të lartë se viti 2016, për arsye se këtë vit buxhetor ka mbaruar dhe afati i garancisë së kryerjes së shërbimeve për mjetin benz, nga autoriteti shitës, për defektet të cilat nuk vareshin nga autoriteti ynë kontraktor, kusht ky i përcaktuar në kontratën e blerjes së mjetit .Peshën më të madhe të këtyre shpenzimeve e zë mjeti furgon pasi është mjet që është blerë prej 12 vitesh dhe ka një amortizim më të lartë nga viti në vit.Në kushtet e sotme të sasisë së të ardhurave që realizon institucioni, nuk mund të planifikohet blerja e një mjeti të ri, pasi edhe nga vlerësimi i tregut për blerjen e këtyre mjeteve të transportit do të ketë një kosto të konsiderueshme , shumë herë më të lartë se vlera e mirëmbajtjes së tij.

Materiale dhe shpenzime specifike, komisione bankare etj. (zëri 17) ,planifikohet në një nivel të konsiderueshëm pasi në këtë zë do të përmbliohen të gjitha shpenzimet për materiale me blerje të vogël që do të jenë të domosdoshme për funksionimin e institucionit.Pjesa tjetër do përballojë

shërbimet e komisionit bankar si dhe shërbime të tjera që janë konsideruar si të domosdoshme nga ana jonë nga praktika e viteve të kaluara.

Kuota e sigurimit të mjeteve (zëri 18) do të përfshijë të gjitha detyrimet tarifore të dy mjeteve pranë DRTR si dhe siguracionet vjetore brënda dhe jashtë shtetit për të dy mjetet.

“Mirëmbajtje e Kaldajave dhe gjeneratorëve dhe kondicioner ” (zëri 30) është planifikuar një fond prej **100.000 lekë** për mirëmbajtjen e tyre ose ndonjë defekt të mundshëm që mund të ndodhi gjatë vitit. Mirëmbajtje kondicioner në vlerën 250.000 lekë , ku me këtë fond do të trajtohet mirëmbajtja e rreth 65 kondicionerëve që janë në institucion.Riparimet e tyre shkojnë nga defekte të vogla 2.000 lekë deri në riparim motori në vlerën 15.000 lekë.Fondi është planifikuar për riparim të tyre në një vlerë mesatare 3.800 lekë /kondicioner në vit, bazuar kjo në realizimin e shpenzimeve të viteve të kaluara.

Në zërin Kosto reklamimi dhe publikimi + buletin (zëri 21) do të përballohen shpenzimet për përgatitjen dhe botimin e katër periodikëve “Kërkime Universitare”, për vitin 2017. Në këtë fond është planifikuar edhe pagesa e redaksisë për përgatitjen e materialeve të këtyre buletineve, si dhe mundësimi i botimit të ndonjë periodiku shtesë nga materialet e konferencës ndërkombëtare që u zhvillua vitin e kaluar me Universitetin e Tiranës “Lufta e Parë Botërore: Ballkani,Shqipëria”.

Pagesa e redaksisë që merret me përgatitjen e buletinit bëhet sipas vendimit Nr.120 datë 27.01.1997 “Për shpërbimin e autorëve të veprave shkencore, teksteve shkollore dhe materialeve të tjera të dokumentacionit shkollor” , ndërsa botimi i buletinit bëhet konform procedurave të prokurimit publik të përcaktuar në Ligjin e prokurimeve.

Kosto legale (mirëmbajtje kontrate, miratim programesh) (zëri 22) në vlerën 700.000 lekë, parashikohen kontratat e mirëmbajtjes së programit të zyrës së financës e personelit , Alfa Buxhetor , në vlerën 108.000 lekë si dhe detyrime të tjera në lidhje me vlerësimin e programeve të reja të studimit që mund të hapen për vitin akademik 2017-2018.Duke qënë se ristrukturimi i sistemit të arsimit ,është një domosdoshmëri për përmbushjen e politikave të institucionit tonë në vazhdim parashikohet krijimi i tre programeve mësimore për të cilat po punohet nga njësitë përkatëse me hartimin dhe trajtimin e problematikave të krijimit të tyre , por që deri në fund të viti 2017 do jenë konkretizuar dhe të bëhet aplikimi për sigurimin e vlerësimit paraprak të tyre.Këto programe të reja studimi parashikohen të jenë në psh.Cikël i dytë studimesh Master Shkencor me profil “Trashëgimi Kulturore” (204.000 lekë).

Zëri Kosto të seancave e bordeve, mbl.senati (zëri 23) është përlogaritur në vlerën 2.500.000 lekë, ku përfshihet shuma vjetore e tarifave (8.000 lekë/ muaj) për mbledhjet e senatit , (për nëntë muaj), mbledhjen e anëtarëve të Këshillit të Administrimit(për 12 muaj), mbështetur këto sipas udhëzimeve në fuqi.

Dieta brenda e jashtë vendit, ekspedita (zëri 24) është planifikuar në një vlerë totale prej 4.700.000 lekë, ku do të përballohet lëvizja e stafit akademik dhe administrativ jashtë rrethit dhe jashtë vendit, për seminare, trainime, konferenca aktivitete dhe projekte të ndryshme në vlerën 4.000.000 lekë. Pas kërkesës së vazhdueshme nga Departamentet përkatëse për praktikën mësimore në

terren, duke qënë se vit pas viti janë reduktuar nga ana jonë, por nga ata është kërkuar me këmbëngulje rivendosja e një fondi në dispozicion planifikohet një fond prej 700.000 lekë , ku për Departamentin e Histori- Gjeografisë 400.000 lekë dhe për Departamentin e Biologji-Kimisë 300.000 lekë. Këto praktika do të planifikohen të bëhen në terren , duke përballuar vetëm lëvizjen e studentëve jashtë rrethit dhe qytetit me transport urban dhe pagesë hoteli deri në 2.000 lekë për akomodimin e tyre në rast se do të ketë intenerare të tilla .Edhe pse në Udhëzuesin e MAS-it për “Hartimin e Projekt Buxhetit të të ardhurave dhe shpenzimeve funksionale për institucionet e sistemit të arsimit për periudhën 2017-2019”, theksohet se këto shpenzime duhet të vijnë në ulje duke rishikuar praktikën mësimore në terren nga cdo Departament ne mendojmë ti mbajme në këtë nivel ,pasi vit për vit kemi bërë reduktimin e tyre dhe nuk mund të realizohet një praktikë mësimore e vlefshme dhe përfaqësuese në terren në vlerë më të ulët se ajo e përcaktuar më lart.

Shërbime të printimit dhe publikimit , (zëri 25) planifikohet në një vlerë 700.000 lekë, krahasimisht më e lartë se ajo e vitit 2017, pasi mund të kemi bashkëpunime me QSA-në botimin e materialeve historike të Rajonit të Jugut, ku universiteti ynë do të jetë bashkëorganizator. Ky fond planifikohet për përballimin e shpenzimeve të skanimit, përkthimit të dokumentave që ndodhen në arshivat e huaja, ku institucioni ynë është në procedim e sipër me QSA-në për kontratën e bashkëpunimit.

Mirëmbajtje e godinave (zëri 26) parashikohet fond në vlerën 6.000.000 lekë, krahasimisht më të lartë se viti 2016, për mirëmbajtjen e godinave në të gjithë aspektet e funksionimit të tyre, gjatë gjithë vitit kalendarik si: lyerje e ambienteve pjesore, meremetime, hidroizolime, mirëmbajtje dhe gjelbërim të ambienteve rrethuese, etj. si dhe pjesën më të madhe rreth 5.300.000 lekë do të jetë fondi për lyerjen e gjithë godinave të jashtme të Universitetit ,pasi gjendja e tyre është shumë e amortizuar pas gjashtë viteve nga lyerja e fundit.

Shpenzime për pritje e përcjellje (zëri 27), në vlerën 500.000 lekë, do të mbulohen pagesat për shpenzimet e pritjes dhe përcjelljes së delegacioneve , pjesëmarrësve në konferencat ndërkombëtare që mund të zhvillohen në Universitetin tonë (për ftesat që u bëhen personave të shquar në fushën akademike), por planifikohet në një vlerë më të lartë se vitin e kaluar , pasi janë nënshkruar marrëveshje me Universitetet e huaja (Poznan ,Poloni dhe Halmstad, Suedi) , ku sipas të cilave mundësohet ardhja e studentëve dhe stafit akademik të tyre për të kryer një cikël studimesh, pranë Universitetit tonë, dhe shpenzimet e akomodimit dhe të ushqimit do të mbulohen nga ana jonë. Për këtë vit buxhetor 2016 nuk është dërguar nga këto universitete asnjë student apo staf akademik , por në vazhdimësi mund të kemi shkëmbime të tilla .

Shpenzime për konferenca ,apo veprimtari lokale (zëri 28) planifikohet në vlerën 500.000 lekë për pagesën e ndonjë takse konference ku mund të paguajmë për pjesëmarrjen në ndonjë konferencë kombëtare që mund të zhvillohen nga Universitetet brënda vendit, si dhe për konferencën kombëtare që organizon Spitali “Omer Nishani” në bashkëpunim me Departamentin e Infermierisë këtu.

Në zërin Aktivitete shkencore të Departamenteve (zëri 30) është planifikuar në vlerën 510.000 lekë, financimi i dy aktiviteteve shkencore të inicuar nga Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe për ish pedagogun e departamentit të Gjuhës e Letërsisë Shqipe Z,Thoma Dhima dhe një aktivitet shkencor për kontributin e Z,jorgo Bulo në Letërsinë Shqipe.

Në vlerën 350.000 lekë është planifikuar konferenca kombëtare që do të organizojë ky Departament me titull “Për autorët e Jugut”

Në zërin Konferenca Ndërkombëtare shkencore (zëri 31) ,është planifikuar një fond prej 2.100.000 lekësh si mbështetje financiare nga institucioni për tre aktivitete shkencore ndërkombëtare , pasi fondi total i kërkuar nga Departamentet përkatëse është rreth 3.000.000 lekë.Planifikohet mundësia e organizimit të një konference ndërkombëtare të inicuar nga Departamenti i Gjeografisë me titull “**Gjeografia e rajoneve ndërkufitare**” ku janë bërë përgatitjet e sesioneve paraprake të konferencës nga antarët e Departamentit.

Sipas platformës shkencore të referimeve dhe kostos financiare të zhvillimit të konferencës së ideuar nga ky departament vlerësojmë që kontributi konkret financiar nga ana e universitetit të jetë në vlerën **700.000 lekë**.Mendohet nga ana jonë që pjesa tjetër e financimit të mbulohet nga Taksa e Pjesëmarrjes së Personave në këtë konferencë, pasi mundësitë për të mbuluar totalisht aktivitetin nuk ekzistojnë. Nga ana jonë do të përballohen shpenzimet për : ftesat, akomodimin e personave të huaj, shtrimi i një kokteji dhe drekë për ditën e zhvillimit të konferencës, si dhe shpenzime të tjera në lidhje me botimin e materialeve të konferencës .Nevojat financiare për pagesën e kumtesave, redaktimin shkencor të tyre nga një grup pune, përgatitjen e materialit përfundimtar të konferencës të mbulohet nga tarifa e regjistrimit në këto konferenca.

Është planifikuar nga ana jonë edhe financimi i konferencës Ndërkombëtare Shkencore me titull “**Ali Pashë Tepelena**” me rastin e 195 vjetorit të vdekjes së tij,të inicuar nga Departamenti i Historisë, si figurë historike me dimensione edhe jashtë kufijve të vendit tonë, në vlerën 800.000 lekë.Pjesa tjetër e financimit të mbulohet nga taksa e pjesëmarrjes në konferencë.

Është planifikuar në vlerën 600.000 lekë Konferenca ndërkombëtare që është kërkuar nga Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe me titull “Akademiku Rexhep Qosja”

Nga ana jonë për të tre këto aktivitete planifikohet në atë masë që të mbulohen shpenzimet në atë formë që janë përshkruar më lart për konferencën e Departamentit të Gjeografisë.

Në zërin Projekt shkencor i Rekonomikut zëri 32) është planifikuar në vlerën 300.000 lekë, financimi i një projekti shkencor të inicuar nga Departamentet e Ekonomikut në bashkëpunim me Departamentin e Historisë dhe Gjeografisë për krijimin e “Hartës së Turistit”. Vlerësohet nga ana jonë si një projekt i rëndësishëm për financim, pasi nga vetë argumentat e bëra nga Departamentet e mësipërme , krijimi i këtij produkti do të ketë një impakt pozitiv për komunitetin e rrethit të Gjirokastrës, për rritjen e cilësisë së turizmit në këtë rreth me një gamë të gjerë atraksionesh turistike duke filluar nga ato kulturore, historike ,arkeologjike , të cilat do të japin një produkt real të prekshëm që është rritja e të ardhurave për bizneset që kryesisht kanë objekt veprimtarie turizmin. E vlerësojmë me vend që Universiteti ynë ,si i vetmi institucion arsimor i lartë publik në rajonin e Jugut , të jetë kontribues në jetën dhe cilësinë e jetesës së këtij komuniteti në aspektin praktik ,duke realizuar edhe një nga politikat

institucionale ,si pjesë e politikave të strategjisë kombëtare ku universiteti të jetë një faktor për zhvillimin e rajoneve.

“Mirëmbajtje dhe riparime Laboratori i Gjuhëve të huaja” (zëri 33) janë planifikuar fonde për riparimin dhe zëvendësimin e disa paisjeve në të dy laboratorët, pasi pas pesë vitesh në përdorim këto laboratore kanë një pjesë të materialeve të amortizuara, të prishura dhe të dëmtuara nga studentët. Ndërhyrja do të konsistojë në zëvendësimin e disa mikrofonëve,të kufjeve ,të cilat janë dëmtuar nga përdorimi pjesa më e madhe e tyre, në kanalinat dhe kabllot e dëmtuara, si dhe në kabinën e përkthimit. Gjendja aktuale nuk mundëson zhvillimin normal të orës mësimore pasi ka dëmtime mekanike të paisjeve si dhe dëmtime nga amortizimi I paisjeve që janë pjesë e sistemit bashkëkomunikues student –pedagog.Brënda fondit të përcaktuar më sipër do të hartohet një preventiv paraprak nga specialist I fushës, për rikuperimin e gjëndjes egzistuese dhe më pas do të ndërmerren procedurat e prokurimit të këtij shërbimi sipas kërkesës që është bërë nga Departamenti I Gjuhëve të Huaja në vlerën që do preventivohet për këto dëmtime.

Në zërin Mirëmbajtje të sistemit të Alarmit dhe të Server Room , (zëri 34) planifikohet një fond prej **300.000 lekë**, ku do të shpenzohet për mirëmbajtjen e këtij sistemi nga dëmtimet e mundshme në:linjat kabllore të sistemit (nëse do të ketë), pastrimi , testimi me aerosol i dedektorëve të server room-it, ndërimi i dedektorëve që mund të dëmtohen me kalimin e kohës, ndërimi i baterive të ushqimit të mini inverterave etj.Instalimi statik i video projektorëve në salla seminaresh ,me rrjet elektrik si dhe kanalina për lidhjen e videoprojektorëve me paisjen etj.për pesë klasa seminaresh.

Në zërin Shpenzime për Qeverinë Studentore: (zëri 35) është planifikuar një vlerë prej 500.000 **lekë** , duke u nisur nga preventivi paraprak i veprimtarive të cilat Këshilli studentor ka planifikuar për vitin 2017.Është parë e arsyeshme të akordohet dhe të menaxhohet ky fond me qëllim aktivizimin dhe mbështetjen e studentëve në veprimtaritë sociale dhe shkencore (në bashkëpunim edhe me Departamentet e Universitetit) për të qënë jo vetëm kontribues për krijimin e të ardhurave për institucionin, por edhe protagonist për veprimtari të cilat kanë një ndikim pozitiv në jetën sociale të qytetit dhe të rajonit të jugut.Edhe pse nuk është hartuar akoma një rregullore e funksionimit të qeverisë studentore,sipas ligjit të ri, nga ana jonë planifikohet ky fond për të mbështetur qeverinë studentore për të financuar veprimtaritë e tyre , sipa nenit 99,pika 6 e ligjit Nr.80/2015 datë 22.07.2015 "Per Arsimin e Larte dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë".

PËR ZËRIN “TRANSFERTA TË JASHTME” 605 , (zëri 36) planifikohet një fond prej **1.000.000 lekësh** për arsye të aderimit të institucionit tonë në organizata ndërkombëtare akademike, të cilat rrisin prestigjin e institucionit tonë , parë kjo si domosdoshmëri edhe për procesin e akreditimit të Universitetit tonë në të ardhmen .

Konkretisht kemi planifikuar në këtë zë dy abonime të cilat kanë qënë të përvitshme dhe janë konsideruar prestigjoze nga ana jonë për faktin që kanë ndikim pozitiv për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe azhornimin me literaturë bashkohore të stafit akademik,për zhvillimin e karrierës së

mëtejshme të tyre . Abonimi në organizatën “**International Association of Universities** ” në vlerën **1.500 Euro** prej më shumë se tetë vitesh, ku kemi edhe te drejtën e votimit për vendimet që merren në këtë organizatë, si dhe pagesa për antarësimin e Departamentit të Matematikës së Universitetit tonë në periodikun Ndërkombëtar “Springer”, ku pagesa e abonimit është **367.5 €** .

Ndërkohë nga kërkesat e ardhura pranë zyrës së Kancelarit nga Departamentet përkatëse planifikojmë edhe dy abonime të tjera të cilat vlerësohen nga ana jonë si mundësi reale dhe e drejtpërdrejtë për integrimin e politikave për thellimin e kërkimit shkencor dhe ritjen e cilësisë së mësimdhënies në institucionin tonë .Këto abonime janë kërkuar nga:

-Departamentet e Ekonomikut , në site : [http:// www.tradingeconomics.com/analytics](http://www.tradingeconomics.com/analytics), ku vlerësohet nga departamentet tona si një database i plotësuar me informacione ekonomike, shkencore të të gjitha fushave dhe që mund të përdoret nga të gjithë antarët e personelit akademik të universitetit tonë dhe jo vetëm nga Departamentet e Ekonomikut.Ky abonim kap vlerën **2.000 euro** në vit.

-Departamenti i Gjeografisë:ka kërkuar abonime për shfrytëzimin e literaturës bashkohore duke synuar azhornimin dhe kompletimin shkencor dhe profesional të stafit akademik dhe të studentëve duke na dhënë disa alternativa abonimi.

Nga ana jonë shihet me interes të gjithanshëm të planifikohet abonimi në një nga sitet e referuar në kërkesën e këtij Departamenti , i cili kap vlerën **3.000 Euro** në vit, pasi në këto site do të kenë akses për ndjekjen e kurseve on line, ku mund të aplikohet edhe nga studentët e këtij programi studimi, për të nxjerrë produkte gjeografike (harta grafikë, tabela,raporte etj) si dhe do të ndihmojë personelin e Departamentit për avancimin e metodikës dhe metodologjisë së mësimdhënies ,duke sinkronizuar arritjet e fundit në shkencën e Gjeografisë.

I jepet prioritet planifikimit të kërkesës së këtij departamenti, pasi në të kaluarën nga ky departament është inicuar një projekt shkencor me Universitetin e Peruxhias në Itali dhe kane kontribuar si departament jo vetëm në realizimin e projektit por edhe në realizimin e një shume prej 2.000 euro të ardhura për institucionin tonë.

Në këtë këndvështrim e quajmë të domosdoshëm planifikimin e këtyre fondeve për të gjitha sa më lart (605) në vlerën **1.000.000 lekë**, duke përbushur edhe një nga kriteret e planifikimit të këtij Buxheti.

Shpenzime për akreditimin e institucionit (zëri 37) ,planifikohet në një vlerë prej 1.600.000 lekë, pasi është një proces i certifikimit të cilësisë së veprimtarisë së institucioneve të arsimit të lartë, në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë dhe shpenzimet për këtë vlerësim duhet të përballohen nga vetë institucioni.Planifikohet në këtë vlerë , sipas Udhëzimit Nr.29/1datë 16.08.2011 “Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve që kryen Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë”,pika 2/a ,duke përlogaritur tarifën prej 1.128.000 lekë për vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin institucional (akreditimi i parë), dhe në vlerën 93.000 lekë sipas pikës 3 të udhëzimit për “Konsulenca të AAAL “ për ti paraprirë përballimit të pagesës në kohë nëse gjatë këtij procesi institucioni do të ketë nevojë të aplikojë për këto lloj vlerësimesh.

-Program studimi dy vjecar –jouniversitar nga FESHSH me profil “Guida Turistike” (188.000 lekë)

-Program studimi dy vjecar –jouniversitar nga FSHN me profil “Mjekësi-laborant” (188.000 lekë)

Kostoja e vlerësimit të këtyre programeve të reja , sipas Udhëzimit Nr.29/1datë 16.08.2011 “Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve që kryen Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë” mund të shkojë deri në **376.000 lekë** (me ekspert vëndas)

Duke qënë se vlerësimi institucional i paraprin atij të programeve të studimit , mendojmë se kjo vlerë do të jetë e mjaftueshme për fazën e parë të akreditimit të institucionit, ndërkohë deri në periudhën Maj 2017, do të kemi situata më të qarta për t`iu referuar pagesave.

3-PLANIFIKIMI I INVESTIMEVE PËR VITIN 2017

- FONDI PËR INVESTIME DHE STUDIME PROJEKTIVE NGA TË ARDHURAT : 15.280.000 lekë

Planifikimi i nevojave për investime për vitin 2017, është bërë mbi një bazë reale kërkesash , të cilat janë paraqitur nga Departamentet me argumentimet përkatëse .

Nisur nga niveli i pritshëm i realizimit të të Ardhurave Dytësore për vitin 2017 , planifikohet për investime vetëm për kërkesa imediate dhe që janë konsideruar si domosdoshmëri për funksionimin e infrastrukturës, si më poshtë:

Rikonstruksion i nyjeve Hidro sanitare në vlerën 6.500.000 lekë. Planifikohet ndërhyrje në të gjitha nyjet e Godinës së mediatekës, të cilat nuk u riparuan vitin e kaluar ,pasi problematika e tyre nuk zgjidhej me ndërhyrje të pjesshme, por duhet të zëvendësohet i gjithë rrjeti i furnizimit me ujë, si dhe ndërhyrje të të gjitha nyjet sanitare të dy godinave të tjera, përvec dy nyjeve sanitare që u rikonstruktuan vitin e kaluar.

Ndërhyrja do të jetë për zëvendësimin e pllakave të sheshit, të zëvendësimit të paisjeve që janë të dëmtuara, të vendosjeve të aksesorëve të rinj, të mbulimit të tubacioneve me tavane të varura etj, për t`i bërë këto nyje sa më funksionale dhe në kuadrin e krijimit të një infrastrukture të pranueshme në kushtet e akreditimit të institucionit.

-Paisje Kompjuterike , planifikohet fond në vlerën **2.000.000** lekë, për plotësimin e kërkesës së Departamenteve të Ekonomikut,të Departamentit të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies dhe të Departamentit të Gjeografisë.Këto kërkesa janë parë të arsyeshme të merren në konsideratë pasi në krahasim me infrastrukturën e çdo Departamenti në Universitet këto Departamente kanë një numër paisjesh të kufizuara ose të amortizuara.

Konkretisht me ndarjen e Departamentit Ekonomik në tre Departamente të tjera nevojitet të shtohet një numër paisjesh për anëtarët e Departamentit si kompjutera, lap top, printer,fotokopjues etj, me qëllim funksionimin normal të punës brënda departamentit.

Gjithashtu planifikimi i disa paisjeve kompjuteri për Departamentin e Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies është i domosdoshëm, pasi duke parë realisht gjëndjen e paisjeve ekzistuese ,edhe nga specialistët e IT-së është sugjeruar rinovimi i 4 kompjuterave të cilët janë shume të hershëm, dhe kanë

edhe problematikën e përshtatjeve të programeve në to apo mos riparimin e tyre si paisje të modeleve të vjetra.

Për Kërkesën e Departamentit të Gjeografisë vlerësojmë që të planifikohet blerja deri në pesë kompjutera nga 20 të këruara dhe më vonë shtimin e tyre.

Blerjen e perdeve statike të videoprojektorëve që u vendosën në 11 salla seminari në muajin Nëntor 2016, për të përmbushur cilësinë e parametrave të mësimdhënies në këto klasa.

- Paisje mobileri : planifikohet një fond prej **800.000** lekë, sipas nevojave të kërkua nga: Departamenti Ekonomik ,Departamenti i Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies , Zyra e ZV/rektorit për mësimin, pasi në këto ambiente ka nevojë për plotësimin e një infrastrukture më të mirë me qëllim krijimin e kushteve më të mira të punës, të mbajtjes së dokumentacionit shkresor nëpër zyra . Këto paisje mobileri përfshin karrige të thjeshta , karrige rrotulluese, dollape dhe poste pune etj. Një peshë specifike e këtij fondi do të jetë dhe plotësimi i magazinës së institucionit me rafte metalike në terrësinë e saj, pasi shume materiale dëmtohen nga lagështia duke prishur cilësinë e tyre. Në këtë fond është parashikuar edhe zëvendësimi i parketit në zyrën e Rektorit , pasi është amortizuar totalisht dhe nuk mund të bëhen riparime të pjeshme .

-Mjete didaktike mësimore (harta laboratorit i Gjeografisë), planifikuar në një vlerë prej **800.000** lekë, sipas kërkesës së Departamentit të Gjeografisë .Për përmirësimin e nivelit të mësimdhënies dhe të konkretizimit të orës mësimore në praktikë, nga ky departament kërkohet paisje me harta dhe mjete mësimore si:harta gjeologjike,tektonike ,pedologjike ,bimore ,hidrologjike ,antikiteti, etj. si dhe mjete të ndryshme për lëndën hartografi.

- për zërin Libra Biblioteke 2.000.000 lekë ,është vlerësuar mundësia për blerjen e një kontigjenti sa më të madh të librave për bibliotekën , fond ky planifikuar në të njëjtin nivel në krahasim me vitin e kaluar ,pasi kërkesat gjithnjë në rritje për tituj shkencor dhe mësimor, na detyron të parashikojmë një vlerë të lartë shpenzimi.

-Studime projektive dhe leje ndërtimi, në vlerën 561.000 lekë planifikohet sipas VKM Nr.354 datë 11.05.2016 “manuali i tarifave për përcaktimin e fondit limit të punimeve të ndërtimit” fond për hartimin e preventivit dhe projektit të zbatimit për rikonstruksionin e nyjeve hidrosanitare të përmendura më sipër, si dhe të lejes së ndërtimit , pranë bashkisë Gjirokastër për kryerjen e punimeve.Këto vlera përlogariten në varësi të fondit limit të planifikuar , por realisht këto tarifa do të planifikohen mbi bazën e fondit të prokuruar të objektit të rikonstruksionit.

-Supervizion dhe kolaudim , në vlerën 218.400 lekë planifikohet sipas VKM Nr.354 datë 11.05.2016 “manuali i tarifave për përcaktimin e fondit limit të punimeve të ndërtimit” për të mbuluar vlerën e shërbimit të mbikqyrjes së punimeve dhe kolaudimit të tyre për objektin e rikonstruksionit të nyjeve hidrosanitare.

-Studime projektive për rishikim projekti,

planifikohet fond në vlerën **2.400.000 lekë** për rishikimin e projekt preventivit të “Rikonstruksionit të Shtëpisë së Ushtarakëve”, pasi me VKM. Nr. 600 datë 28.09.2016 “për kalimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit tek Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) të mjedisëve të ndërtesës “Shtëpia e Ushtarakëve ,Gjirokastër”. Një pjesë e ambienteve të këtij objekti (412 m²) i është dhënë në përdorim dhe pronësi Ministrisë së Inovacionit, duke na detyruar që të bëjmë një rishikim të projektit .Ky fond limit është përcaktuar në masën 40% të fondit fillestar , pasi sipas VKM Nr.354 Datë 11.05.2016, neni 3 pika 3,4 , të masës së ndërhyrjes në këtë projekt duhet të përballojmë shpenzimet për kryerjen e këtij shërbimi (me prokurim elektronik & konkurs projektimi) nga studiot e projektimit.

Nisur nga parashikimi i realizimit të të ardhurave për 2017, të ardhurave të trashëguara nga vitet e kaluara dhe planifikimit të nevojave për vitin 2017 do të japim një bilanc të shpërndarjes së të ardhurave për periudhën 2017-2018 :

BILANCI I parashikimit të SHPËRNDARJES SË TË ARDHURAVE PËR 2017-2018		
	45.197.247	Limiti I pritshëm I realizimit të të ardhurave deri në fund të vitit 2017
	65.615.433	Trashëguar nga të ardhurat deri 2016
	110.812.680	Tw ardhura nw dispozicion pwr vitin 2017
	55.984.000	Parashikohet buxhet I domosdoshëm për shpenzime (paga, shpenzime operative, investime) për 2017
	54.828.680	Mbeten për t`u trashëguar për 2018

Në këto kushte duhet të merren masa që nga të gjitha njësitë kryesore dhe ato bazë të Universitetit, të japin kontributin e tyre për krijimin e burimeve të financimit për institucionin, si :

- aplikimet në projektet e ndryshme ,
- thellimin e punës shkencore, & në lidhje me turizmin, mjedisin,) me rezultate praktike të prekshme
- hapjen e programeve të studimit ku mund të thithim kontigjente studentësh ,
- studimin e tregut të punës për hapje kursesh të ndryshme profesionale me stafin aktual të Universitetit, apo në bashkëpunim me Universitete të tjera.

Nga kërkesat konkrete të Departamenteve vlerësuam si të domosdoshme këto objekte investimi:

Zyra e Kancelarit

Tel. & Fax. 00355 84 26 75 71

e-mail:sotiragoci@yahoo.com

Lista e objekteve të investimit për vitin 2017

	Rikonstruksion I njeve hidro sanitare	6,500,000
	Paisje kompjuterike e elektrike e zyre	2,000,000
	Paisje zyre mobileri dhe zëvendësim parketi zyra Rektorit	800,000
	Mjete didaktike harta lab.gjeografise	800,000
	Libra per bibliotekën	2,000,000
	Studime projektme leje ndertimi	561,600
	Supervizion kolaudim	218,400
	studime projektme Rikonstruksion I SHU rishikim projekti	2,400,000
	Totali	15,280,000

Tabela e përmbledhur e Buxhetit për vitin 2017, sipas zërave kryesor :

Nr	Emërtimi i zërave të Buxhetit	Llogaria Ekonomike	Transferta e pakushtezuar dhe te ardhurat dytësore për vitin 2017		
			Ne lek	Buxhet	Ardhura
1	Paga personeli dhe orë Part Time	600	220.000	200.000	20.000
	Sigurime shoqërore	601	30.000	30.000	
	TOTALI I		250.000	230.000	20.000
2	Shpenzime operative	602	42.200	21.496	20.704
		605	1.000	1.000	0
	TOTALI II		43.200	22.496	20.704
	Investime – stud.projektme				
1	Investime	231	10.318.4	0	10.318.4
2	Studime projektme	230	4.961.6	0	4.961.6
	TOTALI III		15.280		15.280
	TOTALI I + II + III		308.480	252.496	55.984

Duke ju falënderuar për vëmendjen Tuaj në prezantimin e materialit,

KANCELARI

SOTIRA GOCI

Zyra e Kancelarit

Tel. & Fax. 00355 84 26 75 71

e-mail:sotiragoci@yahoo.com

**UNIVERSITETI “EQREM CABEJ”
ZYRA E KANCELARIT**

Gjirokastër më 14.01.2017

RAPORTI VJETOR PËR VITIN 2016.

PREGATITUR NGA :KANCELARI I UNIVERSITETIT

DREJTUAR : SENATIT AKADEMIK të Universitetit “Eqrem Cabej” Gjirokastër

BORDIT të Universitetit “Eqrem Cabej” Gjirokastër

Në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të Ligjit Nr.80/2015 datë 22.07.2015, “Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 32, të Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, gjendjes reale të zbatimit të buxhetit, konform miratimeve të herëpashershme pranë Këshillit të Administrimit të Universitetit “Eqrem Cabej” Gjirokastër , konfirmuar dhe nga Dega e Thesarit Gjirokastër, është përgatitur për miratim Raporti vjetor për vitin 2016 për gjithë veprimtarinë financiare të institucionit si më poshtë:

**BURIMET E FINANCIMIT TË UNIVERSITETIT “EQREM CABEJ”
DHE
MENAXHIMI I FONDEVE TË VITIT 2016**

Për vitin 2016, financimi nga Buxheti i shtetit në formën e trasfertës së pakushtëzuar ishte në vlerën **244.601.000** lekë , e cila e ndarë sipas zërave të shpenzimit jepet në tabelen e mëposhtme:

Nr	Emërtesa	Plani Viti 2016	Realizimi 2016	% real. Me plan.fill
		Trasferta pakushtezuar	Trasferta pakushtezuar	
1	Fondi i pagave shuma	194.004.666	(177.958.604) (1.121.076) 179.079.680	92.3
	Sigurime shoqerore	30.201.000	28.204.402	93.3
	Shpenzime operative	19.995.334	15.746.306	78.7
	Trasferta me jashte	400.000	247.530	62
3	Investime			0
	Gjithsej shpenzime	244.601.000	223.277.918	91.3

Me financimin nga Buxheti i Shtetit, i cili është akorduar në zërin e pagave , kontribute të sigurimeve shoqërore , dhe një pjesë për shpenzime operative, është realizuar pagesa e pagave të punonjësve akademik dhe administrativ, sipas strukturës organike të miratuar për vitin 2016, prej 194 punonjësish.

Në fillim të vitit buxhetor Trasferta e pakushtëzuar e akorduar u planifikua mbi ndryshimin e mundshëm të strukturës akademike dhe administrative të Universitetit, e cila do të implementohej menjëherë pas zgjedhjes së autoriteteve drejtuese të institucionit si dhe krijimit të Bordit të Universitetit në vlerën 206.400.000 lekë fond page, 30.201.000 lekë kontribut i sigurimeve shoqërore dhe 8.000.000 lekë për shpenzime operative .

Gjatë vitit 2016, nga zyra e Kancelarit është kërkuar rialokim fondesh , pasi duke ndjekur realizimin e buxhetit në kohë, fondi i planifikuar për paga dhe sigurime shoqërore do të ishte i pashpenzuar deri në fund të vitit .Për këtë qëllim , duke parë edhe nivelin e të ardhurave të realizuara nga institucioni me miratimin e KA-së së Universitetit është rialokuar për shpenzime operative edhe një fond prej 12.395.334 lekësh me vendimet : Nr.9 datë 22.09.2016 dhe Nr.12 datë 28.10.2016 ,Ky fond do të mbulonte shpenzimet operative të institucionit në përgjithësi si dhe shpenzimet e detyrueshme që përbënin titull ekzekutiv për zbatimin e vendimeve gjyqësore të humbura nga Universiteti, në vlerën 2.395.334 lekë.

Vlera reale e fondit të pagave ishte 172.650.621 lekë dhe pjesa tjetër prej 6.429.059 lekë janë paguar orët suplementare dhe orët e part time të miratuara dhe të kryera pas muajit shtator 2016.

Sic tregon edhe tabela e mësipërme , realizimi i fondeve nuk është i plotë , pasi faktorët që ndikuan në mosrealizimin e fondeve të pagës dhe të shpenzimeve operative ishin :

1-Mos dalja e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit të ri të Arsimit të Lartë , na ka penguar në realizimin e fondit ,pasi nuk u miratua asnjë strukturë e re shtesë nga buxheti i vitit të

kaluar. Planifikimi i fondit të pagave për personel shtesë (administrator Universiteti, administrator fakulteti) rezultoi i papërdorur deri në fund të vitit 2016.

2-Mos miratimi i Departamenteve të Ekonomikut në Fakultet Ekonomik nga MAS-i .

3-dhe nga mos veprimi i Departamenteve të cilat kanë planifikuar aktivitete të ndryshme shkencore ,kombëtare dhe ndërkombëtare dhe nuk kanë realizuar asnjë të tillë përgjatë vitit 2016.

Masa e mbetur e papërdorur nga transferta e pakushtëzuar është 21.323.082 lekë.

Nga fondi i pagave gjatë vitit 2016 është dhënë shpërblime për rast fatkeqësie ose për dalje në pension në një vlerë prej **1.121.076 lek**, ndërsa shpërblim nga fondi i vecantë nuk është dhënë për asnjë punonjës.

Për zërin e investimeve nga Buxheti i Shtetit për vitin 2016, nuk u cel asnjë fond nga MAS-i.

PËR VITIN 2016, FINANCIMI NGA TË ARDHURAT DYTËSORE

KRIJIMI I TË ARDHURAVE DYTËSORE për Universitetin “Eqrem Cabej” Gjirokastrë është si më poshtë :

Nr	Lloji i të ardhurave	Viti 2016
1	Qera	240.852
2	Tarifa Shkollimi	62.787.654
3	Fotokopje e vërtetime e te tjera	512.785
4	Sponsorizime	468.471
5	Tarife regjistrimi e te tjera (kredite te pashlyera)	206.523
	Të tjera	413.074
	SHUMA	64.629.359
	Zbritet si shumë e xhiruar tepër nga posta shqiptare për llogari të Universitetit	1.829.560
	Totali i të ardhurave 2016	62.799.799

Sic shihet edhe nga tabela e krijimit të të ardhurave për vitin 2016, të ardhurat janë realizuar në vlerën 62.799.799 lekë, nga 66.753.400 lek të realizuara në vitin 2015, nivel ky më i ulët në këto vitet e fundit (pasi të ardhura reale janë 62.331.328 lekë, pasi vlera prej 468.471 lekë është sponsorizim nga projekti JWEELL, shpenzimet e financuara pas vlerësimit të performancës së shpenzimeve të këtij projekti nga Ministria e Financave).

Duke analizuar të ardhurat e realizuara në vitin 2010,2011,2013, dhe 2014,2015,dhe 2016, gjatë shtatë viteve të fundit vrehet se: janë rritur të ardhurat e Universitetit, **në një masë të konsiderueshme, kryesisht nga hapja e programeve të studimit “Master Profesional” dhe “Master Shkencor”** pothuajse në të gjitha programet e studimit të Universitetit,ku numri i studentëve të regjistruar ka ardhur në rritje, deri në vitin 2014,ndërsa pas vitit 2014 ka ulje drastike , të arkëtimit të të ardhurave si pasojë e uljes së numrit të studentëve të regjistruar .

Ne vite realizimi i te ardhurave është si më poshtë:

Viti 2010 : 77.445.516 lek
Viti 2011: 77.571.209 lek
Viti 2012: 84.382.759 lek
Viti 2013: 83.934.246 lek
Viti 2014: 91.483.313 lek
Viti 2015: 66.753.400 lek
Viti 2016: 62.799.799 lek

Ulja e nivelit të të ardhurave është rezultat i drejtpërdrejtë i numrit të ulët të studentëve të regjistruar për vitin akademik 2016-2017,krahasimisht me 2014-2015 dhe 2015-2016

Cikli i studimit	2014-2015	2015-2016	2016-2017
Bachelor FESHSH	611	555	499
Part time FESHSH	352	163	97
Bachelor FSHN	496	470	379
Part time FSHN	50	26	15
Master	382	401	237
Totali	1891	1615	1227
Studente përsëritës	100	63	

V.o. Numri i studentëve përsëritës është përfshirë në numrin total të cdo fakulteti.

Sic shihet nga tabela numri i studentëve për vitin akademik 2016-2017 është në rënie, dhe ndikimi i tyre në nivelin e arkëtimit të të ardhurave do jetë tepër i ndjeshëm për vet faktin që numri i studentëve të ciklit të dytë të studimeve (master shkencor dhe profesional) pothuajse është përgjysmuar.

Një vlerë e konsiderueshme e arkëtimit të të ardhurave ishte edhe arkëtimi i tarifës së provimeve të prapambetura që japin studentët e Masterit Profesional dhe Shkencor , të

cilët nuk mbaruan studimet brenda afatit kohor të përcaktuar në legjislacion (1.5 vjet, ose 2 vjet), dhe paguajnë për çdo provim sipas krediteve përkatëse.

Kjo vlerë krijon një masë të qëndrueshme të përvitshme në nivelin e të ardhurave, pasi sistemi part-time është tkurrur totalisht (vetëm një vit ka mbetur), dhe të ardhurat e realizuara nga ky program studimi për vitin 2015 dhe 2016 janë tkurrur në ¼ e vlerës së arkëtimeve të viteve 2010-2013.

Një faktor i cili ndikon negativisht në rritjen e të ardhurave është trajtimi i një numri të madh studentësh, rreth 153 studente, nga të cilët: 125 studentë bachelor të viteve të ndryshme 8 studentë bachelor part-time, dhe 20 studentë Master shkencor dhe profesional), të cilët vijnë nga shtresa sociale, me prindër invalid, ose të përndjekur politik, etj. dhe paguajnë pjesërisht tarifën e shkollimit ose nuk e paguajnë fare, sipas sistemit të studimit përkatës të studentit.

Në krahasim me vitet e tjera numri i studentëve të kësaj shtrese sociale që përfitojnë nga VKM-ja është rritur me rreth 20 studentë.

Vlera e të ardhurave totale për Universitetin për vitin 2016 është :

Struktura e financimit	Sipas thesarit	Realisht
Trashëguar nga 2015	46.298.034	46.298.034
Krijuar në 2016	64.629.359	62.799.799
Totali	110.927.393	109.097.833
Përdorur në 2016	43.482.400	43.482.400
Derdhur tepër nga posta shqiptare	1.829.560	
Trashëgohet për 2017	65.615.433	65.615.433

Sic shihet edhe nga tabela, fondi i trashëguar nga vitet e kaluara, përbën një masë të konsiderueshme të funksionimit të institucionit, pasi shpenzimi nga të ardhurat nuk e kalon masën e trashëguar, duke na dhënë mundësinë që për vitin 2017 të kemi një qëndrueshmëri konstante në planifikimin e shpenzimeve pa u detyruar të bëjmë reduktime radikale të tyre. Kjo situatë kërkon impenjim të të gjitha hallkave të institucionit që çdo njësi e tij të jap një kontribut konkret për të krijuar burime të tjera financimi për universitetin, pasi të ardhurat nga tarifatat e shkollimit janë në ulje të dukshme.

Për vitin 2016, financimi nga të Ardhurat dytësore sipas zërave është:

Nr	Emërtesa shpenzimeve	Viti 2016		
		Limiti i përdorimit	Realizimi	% real. Me plan.fill
1	Fondi i pagave	40.000.000	22.190.618	55.3
2	Shpenzime Operative	19.116.000	14.039.476	73.4
3	Investime	17.353.512	7.252.306	41
	shuma	76.469.512	43.482.400	56.8

Plani i limitit të përdorimit nga të ardhurat dytësore për vitin 2016 në total është 76.469.512 lekë , përfshirë ndryshimet e herepasherëshme, (të cilat janë miratuar rast pas rasti nga KA-ja) dhe realizimi 43.439.390 lekë, ku të detajuar sipas artikujve të shpenzimeve i analizojmë më poshtë:

I- Financimi nga të ardhurat dytësore në zërin e pagave në vlerën **22.190.618 lekë**, ka përfshirë pagesën pjesore të orëve të Part-time , orët jashtë kohës normale të punës , orët suplementare deri në 30 % .Një pjesë e shpenzimeve për paga të sitemit part time, të orëve të miratuara 30-70 % të ngarkesës mësimore me miratim nga Ministri kanë kaluar nga transferta e pakushtëzuar për arsye se kishim fonde të shumta ,duke mbajtur rezervë të ardhurat. Është reduktuar shumë nga ana jonë niveli i përdorimit të të ardhurave edhe për faktin se që nga muaji Qershor 2016 ,nuk është bërë asnjë pagesë për orët mbi kohën normale të punës , të cilat zinin një pjesë të konsiderueshme në buxhetin e të ardhurave, të detyruar nga gjendja reale e arkëtimit të të ardhurave të institucionit.

II-Financimi nga të ardhurat për shpenzimet operative në vlerën 14.039.471 lekë

Fondi për shpenzimet operative është përballuar pjesërisht nga të ardhurat e institucionit pasi një pjesë e transfertës së pakushtëzuar që do të mbetej e lirë në fund të vitit 2016 është rialokuar nga ana jonë për shpenzime operative duke ulur nivelin e përdorimit të tyre nga 29.116.000 lekë në 19.116.000 lekë, dhe realizimi i shpenzimeve të detajuara sipas zërave jepen të detajuara në Regjistrin e Realizimit të prokurimeve publike 2016.

Të gjitha këto rialokime janë kërkuar për miratim në Këshillin e Administrimit dhe janë miratuar me vendimet përkatëse , duke i pasqyruar në Regjistrin e Parashikimeve Publike , të ndryshuar, ku janë njoftuar edhe Zyra e Prokurimeve pranë MAS-it, edhe Dega e Thesarit Gjirokastër.

Shpenzimet sipas zërave të detajuara janë dhënë tek tabela e Regjistrit të Realizimit të Prokurimeve. Në tabelë është dhënë planifikimi dhe realizimi sipas zërave me gjithë ndryshimet përkatëse të miratuara gjatë vitit nga KA-ja.

Nga zëri i shpenzimeve operative u financuan shpenzimet për kontratat e prokurara dhe për shpenzimet me blerje të vogël, ku për arsye se janë planifikuar nga të ardhurat e institucionit , i është dhënë një rëndësi të vecantë efektivitetit të tyre, me qëllim realizimin e shpenzimeve më të domosdoshme për të mbajtur një rezervë që është e trashëgueshme për vitin në vazhdim.

Realizimi i shpenzimeve operative është në vlerën afërsisht 73.4 % dhe e detajuar sipas zërave tregohet në tabelen e realizimit të shpenzimeve si më poshtë:

	Emërtimi I shpenzimeve operative	Shpenzime operative janar – dhjetor 2016	
		Planifikimi	Realizimi
1	Roje civile(kontrate shtese)	475,193	475,193
2	Roje civile	5,408,807	4,988,648
3	Karburant	1,000,000	1,000,000
4	Kanceleri ,boje,fotokopje,printeri etj.	500,000	500,000
5	Kanceleri, shtypeshkrime, bojra	2,500,000	2,356,980
6	Materiale pastrimi	800,000	330,828
7	Sherbime kompjuterike	200,000	158,160
8	Mirembajtje fotokopjuesi	400,000	120,720
9	Materiale elektrike hidraul. Ndert.	1,000,000	649,496
10	Te tjera materiale zyre,	500,000	244,560
11	Energji	2,600,000	2,070,966
12	Uje	700,000	331,771
13	Telefon	1,000,000	545,046
14	Sherbim postar	100,000	88,606
15	Sherbime te ndryshme	1,000,000	912,785
16	Mirembajtje mjet transporti (dy mjete)	800,000	753,014

17	Materiale dhe sherbime specifike	800,000	770,840
18	Kuota e sigurimit te mjeteve	300,000	149,395
19	Sherbime Interneti,	120,000	106,333
20	Miremb te aparateve kondisiner	200,000	90,240
21	Kosto reklam.dhe publik. +buletin	2,000,000	269,962
22	Kosto legale(abonime etj.miremb kontrate)	550,000	108,000
23	Kosto te seanc bordeve ,mbledh senati	5,000,000	4,134,548
24	Dieta, brenda ,jashte, ekspedita	5,000,000	4.751.877
25	sherbime te printimit dhe publikimit	200,000	200,000
26	mirembajtje e godinave	600,000	336,960
27	Shpenzime pritje e percjellje	600,000	238,100
28	Shpenzime për konferenca kombëtare	100,000	0
29	taksë antaresim ne organ. universitare 605	400,000	248,636
30	Aktivitete shkencore departamente	545,000	0
31	Konf.Ndërkomb.shkencore	1,000,000	64.800
32	Mirembajtje e kaldajave e gjenerator	30,000	30,000
33	Ilace mjekesore e laboratorike bio kimia	200,000	146,868
35	Shpenzime per Qeverine studentore	180,000	180,000
36	Mirembajtje e sistemit të alarmit dhe të serverit	307,000	285,932
37	Sherbime specifike (Per vendimet gjyqesore)	2,395,344	2,395,335
	Totali I shpenzimeve operative	39,511,344	30,034,599

Sic shihet edhe nga Regjistri i Realizimit të shpenzimeve ka shumë zëra me mosrealizime në përgjithësi , që kryesisht janë nga mos planifikimi i mirë i fondit të tyre që në fillim të vitit, pasi nuk sillen kërkesa reale dhe shkresore nga Departamentet dhe si

rjedhojë planifikohen nga ana jonë sipas praktikave të vitit të kaluar, pasi gjatë vitit sjellin kërkesa dhe ndodhemi para faktit që nuk kemi fonde ,duke na vënë në vështirësi financiare dhe në kryerjen e një sërë procedurash, të cilat mund të eliminoheshin nëse do të ishin më korrekte Departamentet në kërkesat e tyre me qëllim mbarevajtjen e të gjitha aktiviteteve, mësimore, shkencore e administrative në institucion.

-Kemi një mosrealizim të konsiderueshëm (kursim të fondeve) tek zërat e shpenzimeve të Telefonit dhe Energjisë,Ujë, ku vitet e tjera kemi patur më shumë shpenzime dhe prandaj është planifikuar më shumë në fillim të vitit.Edhe gjatë vitit 2016, është hequr totalisht furnizimi me energji elektrike të objektit të Ish-Shtëpisë së ushtarakëve ,duke lënë vetëm godinën e rojeve civile me energji,dhe për ambientet e dhëna me qera u është kërkuar lidhja e kontratës së furnizimit me energji të bëhet nga vetë qeramarrësit, si dhe janë ulur në vlerë të konsiderueshme shpenzimet telefonike statike në zyrat e universitetit, si dhe ato të telefonisë celulare.Në lidhje me furnizimin e institucionit me ujë , është bërë instalimi i matësit të ujit , duke minimizuar faturën mujore afrore të këtij shërbimi nga 140.000 lekë/muaj në 15.000 -45.000 lekë/muaj.

Në zërat e tjerë ka mos realizime pjesore, për arsye të vlerave të ulëta gjatë prokurimit , si dhe, kryerjen e shërbimeve më emergjente dhe funksionale të nevojat reale,duke rritur efektivitetin e përdorimit të tyre me qëllim grumbullimin e të ardhurave dhe përdorimin e tyre për blerje të laboratoreve, apo shpenzime të tjera në funksion të procesit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.Sic shihet nga tabela e Regjistrit të parashikimit dhe të realizimit të fondeve të shpenzimeve operative të dhënë më lart fondet e prokuruar për “Materiale pastrimi”, (zëri 6), “materiale zyre” (zëri 10) dhe “Materiale elektrike, hidraulike ndërtimi” (zëri 9), ka realizim të ulët për shkak të prokurimeve ku konkurojnë subjekte me vlera shumë të ulëta nga fondi i parashikuar, duke na vënë shumë herë edhe në vështirësi për pranimin e mallrave nga cilësia e tyre (oferta anomalisht të ulëta).

-Një mosrealizim i konsiderueshëm është në zërin Kosto reklamimi dhe dhe publikime + buletine,pasi nga Fakultetet u paraqit materiali vetëm për botimin e dy buletineve , “kërkimeve Universitare” , nga katër të planifikuar cdo vit buxhetor.

-Mosrealizim total kemi në zërat, “Shpenzime për Konferencat Kombëtare” (zëri 28) “Aktivitete Shkencore të Departamenteve” (zëri 30), dhe një vlerë shumë të ulët tek zëri “Konferenca Ndërkombëtare” (zëri 31), pasi nuk u zhvillua asnjë aktivitet i tillë nga Departamentet, si dhe nuk kishim asnjë kërkesë nga ndonjë Departament për zhvillimin e ndonjë konference .

Konkretisht, Departamenti i Ekonomikut nuk realizoi aktivitetin shkencor për 15 vjetorin e krijimit të Departamentit Ekonomik ,si dhe Departamenti i Fizikës nuk realizoi Aktivitetin shkencor “Mbrojtja e Mjedisit nga rezatimi” , ku për të dyja këto aktivitete ishin sjellë kërkesa të detajuara, por nuk u ndërmor nga Departamentet asnjë veprim konkret.Kjo ndodh shpesh në të gjitha rastet duke na vënë para faktit që planifikojmë fonde për mbështetjen e aktiviteteve shkencore dhe Departamentet nuk përpiqen për realizimin e tyre , duke ulur në një nivel shumë të ulët edhe kontributin që duhet të kenë ata për rritjen e kërkimit shkencor

Zyra e Kancelarit

Tel. & Fax. 00355 84 26 75 71

e-mail:sotiragoci@yahoo.com

në institucion apo në zhvillimin e rajonit të jugut ku Universiteti ynë është i vetmi institucion i arsimit të lartë publik.

III- Financimi për investime dhe Studime Projektme, në vlerën 7.252.306 lekë

a)Në zërin e investimeve dhe studime projektme, kemi një realizim prej 41 % të të ardhurave të parashikuara, dhe ky mos realizim ka ardhur si pasojë e prokurimit të objekteve ku ka një vlerë më të ulët se ajo e preventivuar nga specialistët tanë, ose mos realizim procedure .Konkretisht në këtë zë është (referojuni tabelës së shpenzime për investimet)që jepet më poshtë) realizuar pjesa më e madhe e objekteve të planifikuara, por tre prej tyre nuk janë realizuar totalisht. "Për objektin "Laboratori i Elektronikës dhe Elektromagnetizmit" (zëri 8) dhe "Laboratori i Biologjisë" (zëri 4) nuk u realizuan, pasi nga Departamentet sjellin preventiva të cilat praktikisht janë të pamundura të realizohen (sic janë shprehur operatorët ekonomik të cilët konkurojnë),ose specifikimet teknike janë të pa studiuar mirë , duke sjellë vështirësinë e realizimit të tyre.

Për "Laboratori mekanik dhe termodinamik" (zëri 3)u realizua procedura e prokurimit deri në lidhjen e kontratës , por nuk u arrit nga operatori ekonomik të përmbushte kontratën e lidhur me Universitetin, kështu që po procedohet me zgjidhjen e kontratës dhe përemshjen e detyrimeve ligjore që rrjedhin për operatorin në këto raste.Për këtë prokurim edhe në vitin 2015 u gjendëm në kushtet ku operatorët ekonomik nuk mund të gjenin paisjet e kërkuara dhe proceduam me penalitetet e zgjidhjes së kontratës.Pas kësaj nga ana jonë u vu në dispozicion të Departamentit të Fizikës preventivi dhe specifikimet teknike për rishikim, por përsëri edhe me rishikimin e preventivit nga ana e tyre, për vitin 2016 u gjendëm në të njëjtat kushte me zbatimin e kontratës dhe lëvrimin e mallit nga operatori ekonomik.

Në zërin "Libra për bibliotekën" u realizua prokurimi dhe lëvrimi i fondit për dy lotet (Histori- Gjeografi – Letërsi) dhe (Biologji –Kimi), ndërsa për lotin e tretë (Ekonomiku dhe Matematikë –Informatika), u prokurua tre herë dhe nuk u paraqit asnjë operator për konkurim, duke sjellë mosrealizimin e fondit .

Edhe për zërin 11 "Paisje për lëndën e Edukimit Fizik" nuk u ndërmor asnjë prokurim, pasi në kushtet kur nuk kemi ambiente specifike për zhvillimin e kësaj lënde, nuk mund të prokuronim për paisjet e parashikuara. Edhe pse u njoftua Departamenti dhe personat përgjegjës për të planifikuar dicka tjetër në kushtet e ambienteve të Universitetit (paisje portative ose lëvizshme)nga ana e tyre nuk u soll asnjë kërkesë konkrete.

Për objektet e tjera , të cilat janë janë miratuar gjatë vitit në KA-në e Universitetit , kemi një realizim total të tyre, pavarësisht nga vlera pas prokurimit të fondit.

b)Në zërin supervizion kolaudim kemi një mosrealizim (kursim fondi), pasi kontrata për këto shërbime ishte planifikuar në varësi të fondit limit fillestar, ndërkohë me prokurimin e fondit të rikonstruksionit të objektit ky fond ishte i ulët në krahasim me fondin fillestar dhe vlera që tepron është se kontrata e këtyre shërbimeve sipas legjislacionit përkatës është në varësi të fondit të zbatimit të objektit

Vlera e parashikuar dhe ajo e realizuar për të gjithë objektet e investimeve për vitin 2016 është si më poshtë:

Emërtimi i shpenzimeve për investime		Planifikuar	Realizuar
1	Paisje kompjuterike, elektrike 231	3,547,000	3,399,600
2	Paisje Zyre (Mobileri dhe metalike)	508,000	442,560
3	Laboratore mekanik dhe termo dinamik	4,000,000	0
4	Laborator Biologjisë	430,000	0
5	Rikonstr te nyjeve h/ s tek godina e Re dhe Mediateka	1,088,000	956,650
6	Studime projektme	43,000	42,700
7	Supervizion-kolaudim	60,000	32,616
8	Laboratori I Elektronikes dhe Elektromagnetizmit	4,500,000	0
9	Paisje për server room(inverter dhe paisje te tjera)	523,512	480,932
10	Libra per Biblioteken	2,000,000	1,633,914
11	Paisje per lenden e edukimit fizik	250,000	0
12	Ndertimi I rampes per invalidet	404,000	263,334
	Totali	17,353,512	7,252,306

Bashkengjitur keni Evidencen e Realizimit të shpenzimeve Janar- Dhjetor 2016, Evidencen e realizimit të të ardhurave, si dhe Evidencën e të ardhurave te trashëguara për vitin 2016 të konfirmuar nga Dega e Thesarit Gjirokastër.

KANCELARI

SOTIRA GOCI